



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN KËRKESËS PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË KZAZ-VE TË PROPOZUAR NGA PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË DHE ANËTARËVE TË KZAZ-VE TË PROPOZUAR NGA LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e kërkesës për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23 pika 1 gërma a, neni 29, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe propozimet e paraqitura nga partitë politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (këtu e në vijim KQZ), me vendimin nr.18, datë 1.02.2019, dhe vendimin nr.19, datë 1.02.2019, ka përcaktuar partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019.

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në aktet sipërcituar, u paraqitën propozimet për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve vetëm nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Nuk janë paraqitur propozime për



të plotësuar përbërjen e KZAZ-ve nga parti politike të tjera, as brenda afatit ligjor dhe as në tejkalim të tij.

Në raste të tilla, në zbatim të nenit 29, pika 5, të Kodit Zgjedhor, nenit 9, pika 4, të Udhëzimit nr. 2, datë 25.02.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor", i ndryshuar, KQZ emëron kryesisht anëtarë dhe sekretarë për plotësim të vakancave të konstatuara në KZAZ. Rrjedhimisht, KQZ, bazuar në nenin 23, nenin 29, pika 5, nenin 30, nenin 31, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.141 datë 09.04.2019 vendosi të emërojë kryesisht anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Në datë 20.05.2019, Partia "Demokratike" (këtu e në vijim PD) dhe Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim" (këtu e në vijim LSI) i janë drejtuar shkresërisht KQZ (shkresat nr.3994-4020 protokolli) dhe, duke u bazuar te neni 29, pika 5, paragrafi i dytë i Kodit Zgjedhor kanë kërkuar zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar kryesisht nga KQZ me anëtarët e propozuar prej tyre. PD ka paraqitur 268 kandidatura, nga të cilat 225 kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve dhe 43 kandidatura për sekretarë të KZAZ-ve. Nuk janë paraqitur kandidatura për sekretarin e KZAZ-së nr.20 dhe sekretarin e KZAZ-së nr.56. Mbi 30% e kandidaturave të propozuara janë nga secila gjini. Kandidatët e propozuar nga PD për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve plotësojnë kërkesat e nenit 30, dhe nenit 31 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të dy kandidaturave të cilët nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 31, germa "ç". LSI ka paraqitur 90 kandidatura për anëtarë të KZAZ-ve. Kandidatët e propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim për anëtarë të KZAZ-ve plotësojnë kërkesat e nenit 30 dhe nenit 31 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të kandidaturës së propozuar për anëtar të KZAZ nr.15, e cila nuk plotëson kushtin e përcaktuar në nenin 31, germa "ç".

Në datë 23.05.2019 KQZ u mbledh për të marrë vendim "Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë dhe anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019".

Në këtë mbledhje, përfaqësuesi i përhershëm i PD pranë KQZ e argumentoi propozimin duke parashtruar ndër të tjera (cituar sipas procesverbalit të mbledhjes):

*"Më lejoni të bëj një diskutim të shkurtër për aktin pasi është një akt që mbart vlerësim të gjerë publik dhe vjen si përgjigje e një nevojë dhe urgjence që Partia Demokratike dhe Opozita e Bashkuar në tërësi i ka referuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ushtrimin e të drejtës tonë ligjore për plotësimin e vendeve me anëtarë të komisioneve zonal të administrimit zgjedhor. Sipas parashikimit të nenit 28 dhe 29 veçanërisht në këtë rast pikës 5 të nenit 29 që i njuh të drejtën subjekteve që kanë të drejtë për të propozuar anëtar të Komisionit zonal të administrimit zgjedhor dhe në qoftë se nuk paraqesin kandidatura brenda afatit ligjor për momentin fillestar të ngritjes së këtyre komisioneve në një moment tjetër, sigurisht pa penguar procedurat e përgjithshme të procedimit të zgjedhjeve, pra deri 30 ditë para datës së zgjedhjeve, të ushtrojnë të drejtën e tyre ligjore për të plotësuar këto vakanca, duke drejtuar këto kandidatura.*

*Opozita e Bashkuar ka zgjedhur që ta ushtrojë këtë të drejtë ligjore për tu përgjigjur një nevojë të monitorimit të procesit zgjedhor dhe të bërjes transparencë mbi çdo hallkë dhe mbi çdo aspekt të vet pasi janë të shumta denoncimet që kanë mbërritur, një pjesë këtu te ju por pjesa më e madhe në mënyrë institucionale te opozita, të cilët vërtetojnë që çdo hap i procesit zgjedhor në komisionet veçanërisht në komisionet e nivelit dytë të administrimit zgjedhor por dhe nga hallka të tjera të të gjithë strukturës zgjedhore është i mbushur me paligjshmëri dhe kjo sigurisht në funksion të një qëllimi të qartë dhe të një dizajni të qartë të partisë shtet në pushtet e cila*



*pavarësisht se në këto zgjedhje ka krijuar mundësitë, ka krijuar rrethanat që të garojë e vetme, përsëri e vetme në garë, krijon një proces, administron një proces të mbushur me paligjshmëri, paligjshmëri të cilat shkojnë që nga shkelja e afateve në çdo hap të procesit zgjedhor deri në tentativat për emërimin e një opozite fasadë me qëllimin për të zëvendësuar opozitën e vërtetë dhe për të krijuar përshtypjen se në këtë vend do të ketë zgjedhje.”*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, në dritën e rrethanave kur paraqiten këto dy kërkesa/propozime, vlerëson se për të vendosur drejt dhe në respekt të plotë të urdhërimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor duhet të marrë në analizë të gjithë spektrin legjislativ zgjedhor që parashikon mbi ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) si dhe rregullimeve të tjera ligjore absolutisht të lidhura me to e që ndikohen automatikisht nga mënyra sesi formësohen KZAZ.

PD e LSI i bazojnë propozimet e tyre te nenet 28 e 29/5 të Kodit Zgjedhor. Sipas nenit 28:

“1.Vendimi për ngritjen e KZAZ merret nga KQZ-ja *jo më vonë se 90 ditë* para datës së zgjedhjeve.

2. **Partitë politike** propozojnë kandidaturat përkatëse për anëtar të KZAZ-së *jo më vonë se 15 ditë* para afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.”

Ndërsa sipas nenit 29, pikat 1 dhe 5 që kanë rëndësi për çështjen:

“1. KZAZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë dhe sekretari, të cilët emërohen nga KQZ-ja, sipas procedurës së mëposhtme:

a) dy anëtarë propozohen nga **partia kryesore e shumicës parlamentare**, dy anëtarë propozohen nga **partia kryesore e opozitës parlamentare**, një anëtar propozohet nga **partia e dytë e shumicës parlamentare** dhe një anëtar propozohet nga **partia e dytë e opozitës parlamentare**. Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, sipas kësaj shkronje, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik shumicë-opozitë;

b) anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse gjysma tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare...”

[...]

5. Nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZAZ, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 28 të këtij Kodi, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Kur kjo nuk është e mundur, propozimet bëhen sipas pikës 1 shkronja “a” të këtij neni. **Nëse edhe këto parti nuk propozojnë anëtarë, KQZ-ja emëron kryesisht anëtarët e KZAZ-së deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje.**

**Anëtarët e emëruar kryesisht qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e anëtarëve të propozuar nga partitë politike, sipas këtij neni.** Zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 30 ditë nga dita e zgjedhjeve. Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme, zëvendësimi kryhet jo më vonë se 5 ditë nga dita e zgjedhjeve. Procedurat për përzgjedhjen dhe trajnimin e shtetasve që mund të emërohen kryesisht përcaktohen nga KQZ-ja me udhëzim të veçantë.”

Sipas përfaqësuesit të përhershëm të PD pranë KQZ (citur sipas procesverbalit të mbledhjes): “parashikimet ligjore ... i japin Opozitës së Bashkuar të drejtën e pa kushtëzuar në këtë rast të



paraqesin kandidaturat e tyre në Komisionin Zonal të Administrimit zgjedhor ... si një e drejtë ligjore e pakushtëzuar që neni Nr.29 pika 5 i njuh në këtë rast opozitës...”.

KQZ vlerëson se, neni 29, që është baza kryesore ligjore të cilës i referohet PD e LSI, është vetëm një nga dispozitat e Kodit Zgjedhor që rregullon mbi ngritjen dhe funksionimin e organeve të nivelit të dytë e të tretë të administrimit të zgjedhjeve, respektivisht KZAZ dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), apo edhe të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Kodi Zgjedhor në fakt është në tërësinë e tij një kodifikim i së drejtës zgjedhore dhe i problematikave që kjo e drejtë ka paraparë në vite. Neni 29 nuk duhet parë i shkëputur dhe si një i vetëm, po duhet vlerësuar në tërësinë e Kodit Zgjedhor, në kuptimin që qëllimi i nenit 29 të jetë në përputhje edhe me vetë qëllimin e Kodit Zgjedhor. Në fjalët e Gjykatës së lartë të Izraelit, “Një pjesë e ligjit nuk qëndron dot më vete. Ajo është pjesë e një trupi ligjor. Integrohet në të, në mënyrë që ligji të jetë harmonik. Kushdo që interpreton një pjesë të ligjit, interpreton ligjin si një të tërë” (Gjykata e Lartë e Izraelit, çështja *Efrat v. Drejtorisë së Regjistrimit të Popullatës H.C.693/91*).

KQZ në këtë rast, duhet ta interpretojë nenin 29 në dritën e qëllimit të Kodit Zgjedhor si një i tërë. Çdo sistem/teknikë interpretimi synon të zgjidhë marrëdhënien ndërmjet tekstit dhe kontekstit, apo e thënë ndryshe, ndërmjet fjalëve në tekst dhe shpirtit të ligjit. Synimi i interpretimit të një teksti ligjor është të kuptuarit e qëllimit për të cilin shërben ai tekst, pasi në fund të fundit ligji nuk është gjë tjetër veçse një instrument për arritjen e një qëllimi shoqëror. Ai ka për qëllim nga njëra anë të sigurojë zhvillimin e jetës shoqërore të një komuniteti dhe nga ana tjetër të mbrojë të drejtat e njeriut dhe drejtësinë shoqërore. Qëllimi final i një teksti ligjor përcaktohet nga marrëdhënie ndërmjet elementëve subjektivë (qëllimi real i autorit) dhe atyre objektive (qëllimi i ligjit brenda kuadrit legjislativ të shtetit). Pësia më e madhe u duhet dhënë qëllimeve objektive; e shkuara e influencon të tashmen, por nuk e përcakton atë; drejton drejt të tashmes por nuk e skllavëron atë! Çdo ligj ka një qëllim, pa të cilin ai s’ka kuptim. Ky qëllim, apo *ratio legis* përbëhet nga objektivat, synimet, interesat, vlerat, politikat dhe funksionet për të cilat ligji është hartuar të realizojë. Qëllimi objektiv i një ligji nënkupton interesat, vlerat, objektivat, politikat dhe funksionet që ligji duhet të realizojë në një demokraci. **Janë kriteret objektive në momentin e interpretimit ato që përcaktojnë se cili është qëllimi i ligjit.** Qëllimi objektiv i një ligji deduktohet nga **natyra e çështjeve** që ky ligj rregullon.<sup>1</sup>

Nëse do ti referohemi jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), kjo e fundit e ka cilësuar Konventën si “një instrument të gjallë që duhet të interpretohet në dritën e kushteve të sotme” ( çështja *Tyrrer kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 25 prillit 1978). Në procesin e saj të interpretimit, GJEDNJ shpesh thekson **objektin** dhe **qëllimin** e Konventës Evropiane për të justifikuar një interpretim të caktuar. GJEDNJ e ka konfirmuar këtë në jurisprudencën e vet duke pretenduar se nuk e konsideron veten të lidhur me të kuptuarit e palëve në kohën e ratifikimit. Dokumenti thelbësor në vendosjen e objektit dhe qëllimit sipas GJEDNJ duhet të jetë preambula (shiko për më shumë çështjen *Groppera Radio AG dhe të tjerë v. Zvicrës*, e datës 28.03.1990).

Interpretimi i një neni duke iu referuar dhe mbajtur parasysh edhe neneve të tjera të po atij ligji apo kodi (interpretimi *sistematik*), e gjitha kjo e drejtuar nga qëllimi dhe objektivat e ligjit

<sup>1</sup> Aharon Barak, *The Judge in a Democracy*, Princeton University Press, 2006.



(interpretimi *teleologjik*) është interpretimi i përdorur më shpesh jo vetëm nga GjEDNJ, por edhe nga Gjykata Kushtetuese shqiptare.<sup>2</sup>

Interpretimi teleologjik fillon nga supozimi se legjislacioni është hartuar në mënyrë të arsyeshme me një qëllim të caktuar apo se legjislacioni shërben si një instrument për të arritur "qëllime të caktuara ligjore, sociale ose ekonomike". Sipas kësaj metode, çdo interpretim duhet të jetë në përputhje me këtë qëllim të veçantë. Për ta thënë ndryshe: "kuptimi i një rregulli ligjor duhet të vendoset në bazë të së mirës që rregulli ka për qëllim të promovojë ose të keqes që kërkon të shmangë". Kjo do të thotë që pasojat e interpretimit të një teksti ligjor në një mënyrë të caktuar duhet të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të këtij teksti ligjor dhe jo interesave të vogla e pragmatiste të subjekteve të ligjit.

KQZ shpreh bindjen se i gjithë Kodi Zgjedhor është ngritur dhe konceptuar mbi bazën e parimit të pjesëmarrjes, përfshirjes dhe balancimit **të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje**.

Dhe kjo është e kuptueshme dhe logjike duke e lidhur ngushtësisht edhe me **qëllimin** e shpallur që në nenin 1, paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet shprehimisht se:

"1. Ky Kod ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet."

Duke iu kthyer tekstit të nenit 29 të Kodit Zgjedhor, KQZ arsyeton se përdorimi i termave si "partia kryesore e shumicës parlamentare", "partia kryesore e opozitës parlamentare", "partia e dytë e shumicës parlamentare" dhe "partia e dytë e opozitës parlamentare", apo e thënë ndryshe, evidentimi në tekst vetëm i togfjalëshit "parti parlamentare", pa e lidhur këtë me diçka tjetër (si p.sh. parti parlamentare të regjistruara në zgjedhje) është e kuptueshme dhe në respekt të logjikës kohore kur ngrihen KZAZ, pra *jo më vonë se 90 ditë* para datës së zgjedhjeve, ndërkohë që, sipas nenit 64, pika 1 e të Kodit Zgjedhor, "Çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ *jo më vonë se 70 ditë* përpara datës së zgjedhjeve." Pra, legjislatori arsyeshëm iu drejtohet subjekteve të Kodit Zgjedhor në këtë rast vetëm si "parti parlamentare" (të shumicës apo opozitës), pasi momenti kohor i ngritjes së KZAZ është më i hershëm në kohë sesa regjistrimi i partive politike në zgjedhje. Kjo shpjegon edhe faktin se përse KQZ nuk e sheh të arsyeshme të ndryshojë Vendimin nr.18, datë 1.02.2019, dhe Vendimin nr.19, datë 1.02.2019 të tij, përmes të cilëve KQZ ka përcaktuar partitë politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019. Këto akte individuale të KQZ janë korrektë për kohën kur janë marrë dhe ndryshimi apo lënia në fuqi e tyre nuk ka ndikim në situatën aktuale.

Nga ana tjetër, vërehet qartë se, pas kalimit të afatit 70 ditor, të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, ligjvënësi fillon dhe e ndryshon terminologjinë e Kodit; ai nuk thotë më "partitë parlamentare", por fillon në nenet vijuese pas nenit 29 dhe e ndryshon terminologjinë duke përdorur cilësimin "subjekti zgjedhor i regjistruar në zgjedhje".

Neni 29 i Kodit është norma që rregullon sesi emërohen anëtarët e KZAZ, por neni 32 po aty është norma që rregullon sesi shkarkohen dhe lirohen ata. Janë dy nene që përmbyllin të njëjtin

<sup>2</sup> Shiko për më shumë Vendimi nr.2, datë 18.01.2005, Vendimi nr. 25, datë 05.12.2008, etj.



segment logjik. Por ndryshe nga neni 29, i cili sidoqoftë është një rregullim korrekt për marrëdhënien që rregullon në periudhën kohore *jo më vonë se 90 ditë* para datës së zgjedhjeve, neni 32, në pikat 2 e 3 të tij është po aq i qartë kur parashikon se:

“2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

d) **subjekti zgjedhor** që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim **të subjekteve zgjedhore**, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen.”

Ligji, si *esenca e arsyes*, nuk mund të krijojë situata të tilla absurde kur anëtarët e KZAZ, ndërsa emërohen nga parti parlamentare të caktuara, nuk mund të zëvendësohen apo të shkarkohen më prej tyre. Përkundrazi, është lehtësisht e kuptueshme se, në kuptim të parimit të pjesëmarrjes, përfshirjes dhe balancimit **të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje** si dhe të qëllimit numër 1 të Kodit i cili është realizimi i zgjedhjeve (dhe jo dështimi apo sabotimi i tyre), megjithëse në periudhën deri 90 ditë përpara datës së zgjedhjeve janë (vetëm) disa parti politike parlamentare ato që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ, pas kalimit të afatit “*jo më vonë se 70 ditë* përpara datës së zgjedhjeve” të parashikuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor mundësinë për të propozuar emërimet, lirimet dhe shkarkimet e tyre i kanë vetëm partitë politike që gëzojnë njëkohësisht edhe statusin e subjekteve zgjedhore.

Sipas nenit 2 të Kodit Zgjedhor, “Parti parlamentare” është partia politike që ka fituar dhe zotëron të paktën një vend në Kuvend nga zgjedhjet pararendëse ndërsa “Subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.

Duke mos u regjistruar në KQZ brenda afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, PD dhe LSI nuk e gëzojnë statusin e subjekteve zgjedhore.

KQZ vlerëson se neni 29 është pazgjydhshmërisht i lidhur edhe me nenet 36, 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, të cilët rregullojnë në lidhje me përbërjen e KQV dhe GNV. Sipas nenit 36, pika 1, “KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kriterëve të nenit 29 të këtij Kodi për çdo lloj zgjedhjeje...”. Për pasojë, në hipotezën absurde se KQZ do e lexojë nenin 29 të shkëputur nga nenet e tjera të Kodit Zgjedhor dhe në neglizhencë të plotë të qëllimit të Kodit Zgjedhor, atëherë do të rezultojë që PD e LSI do të kenë anëtarë edhe në KQV.

Në të njëjtën (a)logjikë do të pasonte edhe ngritja e GNV, pasi neni 95, pika 2 parashikon se “Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtari i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtari i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi.” Në terma praktikë, PD e LSI, dy parti që nuk janë regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje, do të kishin edhe numërues votash.

Për fat të mirë, megjithëse në kohën kur Kodi Zgjedhor u hartua nuk mund të parashikohej një situatë e tillë kur dy partitë më të mëdha të opozitës parlamentare heqin dorë nga mandatet parlamentare dhe refuzojnë të hyjnë në zgjedhje, legjislatori sërish ndihmon me parashikimin e nenit 96 sipas të cilit “Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës **së partive politike të shumicës**



**parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje** dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë.”

Në këtë pikë, si në respekt të interpretimit sistematik e teleologjik të normativës së Kodit Zgjedhor, ashtu edhe të interpretimit logjik nga e kundërta, rezulton se anëtarë të KZAZ, KQV dhe GNV mund të propozojnë vetëm **partitë politike të shumicës parlamentare dhe partitë e opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje.**

Neni 6 i Kodit Zgjedhor parashikon se “Çdo parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, **i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor**, ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore.” Si mund të mendohet se, legjislatori i cili pa asnjë dyshim nuk u ka dhënë partive që nuk regjistrohen në zgjedhje as të drejtë për vëzhgues, t’u ketë dhënë të drejtë për të propozuar anëtarë në KZAZ, KQV dhe GNV?! Arsyeja është e qartë: partitë që nuk regjistrohen në zgjedhje nuk kanë një interes personal, të drejtpërdrejtë dhe real për të pasur të drejta të tilla.

Kjo konfirmohet së fundi edhe nga pamundësia që kanë partitë që nuk janë subjekte zgjedhore për t’i kërkuar gjyqësisht këto pretendime. Neni 145 i Kodit Zgjedhor që rregullon mbi të drejtën e ankimit në gjykatë parashikon se “**Subjektet zgjedhore** kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.”

Në çdo raport të OSBE-ODIHR mbi zgjedhjet në Shqipëri pranohet se “pavarësisht mangësive, Kuadri ligjor mundi të ofronte bazën për zgjedhje demokratike”.<sup>3</sup> Në asnjë rrethanë këto Raporte nuk do të shpreheshin kështu, nëse Kodi Zgjedhor nuk do të parashikonte një procedurë garantuese për një të drejtë të shpallur nga nenet e tij. Fakti që Kodi parashikon se të drejtën për ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së, e kanë **vetëm subjektet zgjedhore**, kur vendimi i KQZ iu ka cenuar interesat e tyre të ligjshëm, është tregues i qartë se pretendimi në këtë fazë të procesit zgjedhor nga PD e LSI, dy parti që nuk janë subjekte zgjedhore, thjesht nuk ka lidhje me ndonjë interes të ligjshëm që atyre iu është cenuar.

Kolegji Zgjedhor është shprehur në lidhje me nenin 29 të Kodit Zgjedhor duke thënë shprehimisht se:

*“Në nenin 29 të Kodit Zgjedhor, parashikohet formula/jepen modalitetet për emërimin e anëtarëve dhe formimin e KZAZ-ve që si rregull realizohet ndërmjet **propozimeve të subjekteve zgjedhore (që gëzojnë cilësitë e shumicës e pakicës parlamentare)** duke krijuar baraspeshim politik.”<sup>4</sup>*

Edhe nga kjo vendimmarrje e Kolegjit Zgjedhor rezulton qartë se, që të kesh të drejtën për të propozuar anëtarë në KZAZ duhet të gëzosh në të njëjtën kohë edhe cilësinë e subjektit zgjedhor edhe cilësinë e shumicës apo të pakicës parlamentare.

<sup>3</sup> Shiko për më shumë Raportet Përfundimtare të Misionit të OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve 2015, 2017.

<sup>4</sup> *Vendimi nr. 29, datë 10.07.2015 i Kolegjit Zgjedhor, marrë nga “Përmbledhje të vendimeve të Kolegjit Zgjedhor” faqe 490-491, Botim i OSBE, 2016.*



Atëherë logjikshëm shkojmë tek koncepti i SUBJEKTIT ZGJEDHOR në kuptim të Kodit Zgjedhor, si më poshtë:

Sipas nenit 2/20

20. "Subjekte zgjedhore" janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, **të regjistruar në përputhje me këtë Kod.**

Sipas parashikimeve të nenit Neni 63 "Subjektet zgjedhore dhe kandidatët të Kodit Zgjedhor", **subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh**, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.

Në analizë të neneve të sipërcituara të Kodit Zgjedhor, lehtësisht, mund të arrihet në konkluzionin se vetëm pjesëmarrja në procesin zgjedhor, garimi në procesin zgjedhësor sipas rregullave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor të jep cilësinë e subjektit zgjedhor.

Dhe sa më sipër, dukshëm, subjektet politike kërkuese nuk përmbushin kriterin ligjor për të qenë subjekt zgjedhor në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019, sepse subjektet politike në fjalë:

- nuk janë regjistruar në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, fakt i njohur botërisht;
- nuk kanë paraqitur përfaqësuesit e tij në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në nenin 29 dhe jo vetëm të Kodit Zgjedhor;
- nuk kanë paraqitur asnjë interes dhe asnjë qasje për përfshirje në këtë proces zgjedhor, përveçse kërkesës objekt shqyrtimi.

Sa më sipër theksojmë se subjekti politik kërkues nuk përmbush njërin nga dy kriteret njëherazi të shprehura nga Kolegji Zgjedhor, pra nuk gëzon cilësinë e subjektit zgjedhor, që të mund të përfshihet nën parashikimet e nenit 29 të Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte, KQZ gjykon se subjektet politike që kanë paraqitur kërkesën nuk kanë asnjë interes të ligjshëm të drejtpërdrejtë për t'u bërë pjesë e procesit zgjedhor që refuzon publikisht të jetë pjesë.

*Interesi duhet të jetë i drejtpërdrejtë, personal dhe real.* Ky kusht kërkon realizimin e një të drejte që ka lidhje të drejtpërdrejtë me subjektin që e ka paraqitur kërkesën përpara çdo organi tjetër kompetent të administratës shtetërore, përfshirë këtu KQZ në rastin konkret.

Askush nuk mund t'i drejtohet një organi për të arritur respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të dikujt tjetër, në këtë rast dy parti politike që nuk marrin pjesë në zgjedhje që shfaqen si mbrojtëse të partive politike subjekte zgjedhore dhe të interesave të qytetarëve që praktikisht nuk i përfaqësojnë në zgjedhje.

Deklarimet publike në vazhdimësi të PD e LSI se "zgjedhje në 30 qershor 2019 nuk do të ketë" apo se "zgjedhjet nuk do të bëhen", bien ndesh haptazi me objektin e normës të vendosur si bazë ligjore në kërkesën e subjektit politik dhe në përgjithësi me qëllimin e Kodit Zgjedhor.





Partitë politike janë në radhë të parë organizata për përgatitjen e zgjedhjeve. Si të tilla ato formojnë, modelojnë vullnetin e popullit si organizata zgjedhore.<sup>5</sup>

Abuzim me të drejtën përshkruan rastin kur një subjekt që ushtron një të drejtë të tij, nuk mund ta përdorë si pretekst (*shkak i jashtëm që paraqitet si i tillë sa për sy e faqe, për të mbuluar ose për të fshehur arsyet e verëteta të një ngjarjeje, të një verpimi a të një dickaje tjetër, shkak i rremë ku kapet dikush*) me qëllimin e vetëm për të krijuar dëm (e në rastin konkret dëmi është përkundrajt procesit zgjedhor në vend).

KQZ nuk mund të pranojë kërkesën e paraqitur pasi sikurse theksuam edhe më lartë subjektet politike kërkuese nuk gëzojnë dy elementë shumë të rëndësishëm në të njëjtën kohë, qënien subjekt zgjedhor dhe cilësinë e shumicës apo të pakicës parlamentare sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Nëse KQZ refuzon kërkesën e paraqitur nga subjekti politik, **subjektit politik që nuk garon në zgjedhje nuk i cënohet asnjë e drejtë e tillë si: e drejta për të zgjedhur, e drejta për t'u zgjedhur, e drejta e votës, barazia e votës apo e drejta për të marrë pjesë në zgjedhje.**

Asnjë e drejtë nuk cënohet, përkundrazi KQZ i jep një mbrojtje të posaçme procesit zgjedhor.

Është detyrë e KQZ të kujdeset dhe të menaxhoje procesin zgjedhor duke patur në konsideratë parimin e luajalitetit ndaj shtetit (Gjykata e Strasburgut në çështjen *Tanase v. Moldova* parag. 166).

Vendimi i refuzimit të listave sipas propozimit kërkuesve PD e LSI është në përputhje të plotë edhe me parashikimet e nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative, nen i cili parashikon Parimin e proporcionalitetit si më poshtë:

1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:
  - a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cënojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
  - b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe
  - c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Vendimi i KQZ është proporcional dhe konsiston në ushtrimin e masës së duhur të pushtetit në mënyrë të tillë që të sigurojë një veprim të përshtatshëm dhe të nevojshëm në lidhje edhe me rrethanat e faktit duke u përpjekur të gjejë ekuilibrin e duhur ndërmjet vlerave, interesave dhe situatave juridike të rastit në fjalë. Vendimi i KQZ si akt administrativ është një masë e tillë që synon të kurojë interesin publik, interesin publik për të votuar.

E drejta nuk e ka forcën të shkëputet nga realiteti me të cilin është e lidhur dhe është ngritur si një sistem i tërë normativ, i pavarur dhe i vetëvendosur. Dhe kjo në kuptimin që, neni 29 nuk duhet parë i shkëputur dhe si një i vetëm, po duhet vlerësuar në tërësinë e Kodit Zgjedhor, në

<sup>5</sup> Çështja "Financat e partive politike III" 1966, Gjykata Kushtetuese Gjermane.



kuptimin që qëllimi i nenit 29 është në përputhje edhe me vetë qëllimin e Kodit Zgjedhor, që administratva zgjedhore të jetë në gjendje të organizojë procesin zgjedhor.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e pasur me vendimmarrje të cilat lidhen në mënyrë të posaçme me të drejtën e parashikuar nga neni 3 i Protokollit nr.1 i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në një sërë vendimesh, kjo gjykatë është shprehur duke vlerësuar aspekte të ndryshme të tilla si kuptimi dhe qëllimi, parimet e interpretimit, aspekti aktiv i të drejtës për të votuar si edhe **rëndësinë e kontekstit historik dhe politik** duke cituar shprehimisht:

*“Për qëllime të zbatimit të nenit 3, çdo legjislacion zgjedhor duhet të vlerësohet në dritën e evolucionit politik të vendit në fjalë, në mënyrë që karakteristikat që do të jetë e papranueshme në kontekstin e një sistemi mund të justifikohet në kontekstin e një tjetër, por edhe për të shpjeguar çdo evolucion në nivelin e kërkesës në varësi të periudhës në shqyrtim. Disa nga këto raste janë: (Mathieu-Mohin dhe Clerfayt v. Belgjikës PODKOLZINA v. Lituanisë).*

Në respekt të arsytimit më sipër, KQZ gjykon se Partia Demokratike e Shqipërisë dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim duke mos u regjistruar në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019 nuk përmbushin kriterin ligjor për të qenë subjekt zgjedhor në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të datës 30 qershor 2019 dhe për pasojë nuk mund të propozojnë në këtë fazë të procesit zgjedhor anëtarë për KZAZ (e respektivisht edhe për KQV e GNV).

## **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23 pika 1 gërma a, nenin 29, të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Të rrëzojë kërkesën për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Të rrëzojë kërkesën për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, të propozuar nga Lëvizja Socialiste e Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

